



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

V E N D I M

Nr. 59, Datë 20/02/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 20, datë 06.02.2018, e Z. E. H., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike” dhe “për çdo shkak tjetër”, nga ana e Z. A. M., ish-drejtor i Spitalit “Omer Nishani”, Gjirokastrë.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se Z. E. H. ka qenë në marrëdhënie pune me Spitalin Rajonal Gjirokastrë, prej datës 16.11.1999, me detyrë infermier. Me Urdhërin nr. 69/2, datë 14.02.2014, të Drejtorit të Spitalit Rajonal Gjirokastrë, ankuesi është liruar nga detyra. Z. E. H pretendon se është liruar nga detyra për shkak të bindjeve politike¹.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 20, datë 06.02.2018, së Z. E. H., Komisioneri konstatoi se:

¹ Në ankesë nuk është dhënë informacion mbi kahun e bindjeve politike të ankuesit, si dhe nuk është paraqitur asnjë dokument/akt që të vërtetojë bindjet e tij politike.